

fshatin

penë, gjendje

, në paraburgim që më 25 mars 2009,

Pas deklaramit fajtor për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me me Nenin 147, Pikat 3) dhe 10) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafët (1) dhe (2) të KPPK, sipas Marrëveshjes së Pranimit të Fajësisë, të datës 9 nëntor 2010 dhe pasi Gjykata e ka pranuar Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë, më 22 nëntor 2010, siç është regjistruar në Gjykatë më 22 nëntor 2010,

Ai

DËNOHET

- me 12 /dymbëdhjetë/ vjet burgim për veprën penale të Vrasjes së Rëndë
- me 2 /dy/ vjet burgim për veprën penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve.

Dënimi unik përcaktohet si **13 /trembëdhjetë/ vjet burgim**, sipas Nenit 71, Paragrafit (1) dhe Paragrafir (2), Pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim që më 25 mars 2009, do të përllorarit, sipas Nenit 73, Paragrafit (1) të KPK.

I Akuzuari do të riimbursojë shpenzimet e procedurës penale, sipas Nenit 102, Paragrafi (1) të KPPK, me përjashtimin e shpenzimeve të përkthimit me gojë e me shkrim. Një vendim i veçantë lidhur me shpenzimet, do të dorëzohet nga Gjykata, pas marrjes së të dhënave të tilla, në bazë të Nenit 100, Paragrafi (2) të KPPK.

ARSYETIMI

A. PREJARDHJA PROCEDURIALE

Prokurorja Publike e Qarkut për Mitrovicën, në Aktakuzën PP. Nr. 256/04, të datës 25 mars 2010, siç është ndryshuar më 6 dhe 19 prill 2010, dhe që është konfirmuar me anë të Aktvendimit KA. No.15/10, të datës 2 qershor 2010, e akuzon Mensur Isufin për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me me Nenin 147, Pikat 3) dhe 10) të Kodit të Përkohshëm Penal të Kosovës (KPPK) dhe Pronësi, Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafët (1) dhe (2) të KPPK.

Gjykimi kryesor ishte caktuar për të filluar më 10 nëntor 2010, por fillimi i gjykimit u shty, për shkak të negociatave që po zhvilloheshin mes palëve lidhur me fajësinë. Më 22 nëntor 2010, Prokurorja e EULEX-it e informoi Gjykatën se kishte përfunduar Marrëveshja mbi Fajësinë dhe ajo ishte nënshkruar nga palët dhe nga Kryeprokurori Publik.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Sipas Nenit 23, Pika 1) i) të KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente për të shqyrtuar veprat penale që përfshijnë akuza për të cilat ligji lejon caktimin e dënimit penal prej të paktën pesë vitesh. Sipas Nenit 27, Paragrafi (1) të KPPK, juridiksioni territorial i takon asaj gjykate qarku, ku aludohet se është kryer një vepër penale.

Siç përcaktohet më sipër, akuza për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, sipas Nenit 147 të KPK, lejon caktimin e dënimit minimal prej 10 vjetësh burgim. Përveç kësaj, aktakuza në këtë rast, aludon që i akuzuari i ka kryer veprat penale në Duboqak-Palevinë.

Prandaj, Gjykata e Qarkut të Mitrovicës, është organi kompetent gjyqësor për të shqyrtuar këtë procedurë penale.

Më 2 gusht 2010, Kryetarja e Asamblesë së Gjyqtarëve të EULEX-it, ia caktoi lëndën gjyqtarëve të EULEX-it, duke u bazuar në Nenin 3.3 të Ligjit mbi Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it.

Prandaj, Gjyqtarët e EULEX-it të Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës janë kompetentë për të shqyrtuar këtë lëndë. Trupi gjykues përbëhet nga Gjyqtarja Penaliste e EULEX-it, Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e Trupit Gjykues, dhe Gjyqtarët e EULEX-it Christine Lindemann-Proetel dhe Nikolay Entchev, si anëtarë të trupit gjykues. Që të tri gjyqtarët janë të caktuar për Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë.

Askush nga palët nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues.

C. MARRËVESHJA MBI FAJËSINË

Një marrëveshje mbi fajësinë iu paraqit Gjykatës gjatë seancës publike, sipas Nenit 308A, Paragrafi (9) të KPPK, më 22 nëntor 2010.

I Akuzuari Mensur Isufi e pranoi fajësinë për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, në kundërshtim me me Nenin 147, Pika 10) të Kodit Penal të Kosovës (KPPK) dhe Pronësi,

Kontroll, Posedim apo Përdorim të Paautorizuar të Armëve, në kundërshtim me Nenin 328, Paragrafët (1) dhe (2) të KPK, me kualifikimin e saktë sipas Nenit 328, Paragrafi (2) të KPK, siç është pranuar nga Gjykata.

Marrëveshja mbi Fajësinë përmban gjetjet e mëposhtme faktike:

“Më 11 shtator 2004, i dyshuari shkoi në një vend të quajtur Duboqak – Palevinë, së bashku me djemtë e xhaxhait të tij, të quajtur R dhe B, me qëllim që të prisnin dru në pyllin e qeverisë bashkë me djemtë e xhaxhait, R dhe B. Ndërsa po prisnin dru, aty erdhi roja H. H ishte caktuar të ruante pyllin qeveritar dhe pas disa shkëmbimeve mes këtij personi dhe të dyshuarit, i dyshuari nxorri një pistoletë dhe qëlloi mbi rojen e pyllit. Viktima vdiq në vendin e ngjarjes. Kjo u dëshmuar edhe nga R dhe B. Pylli është pyll shtetëror.”

I Akuzuari Mensur Isufi nuk kishte një autorizim të vlefshëm për pistoletën. Arma nuk u sekuestruar gjatë hetimit dhe vendndodhja e saj mbetet e panjohur.

Palët e Lënduara, K, djali i viktimës H, dhe P, vëllai i viktimës, ishin të pranishëm në seancën publike të datës 22 nëntor 2010. Palët e Lënduara konfirmuan se ata ishin njoftuar nga prokurorja lidhur me Marrëveshjen mbi Fajësinë.

Sipas Nenit 308A, Paragrafi (5) të KPPK, Palës së Lënduar duhet t'i jepet mundësia të paraqesë një deklaratë në Gjykatë lidhur me padinë pronësore. Në çështjen në fjalë, asnjëra nga Palët e Lënduara – pasi iu dhanë udhëzimet përkatëse – nuk dorëzuan një padi të tillë, por shprehën dëshirën e tyre për të kërkuar kompensim në një fazë të mëvonshme, përmes procedurës civile. Atyre iu dha mundësia të paraqisnin komentet e tyre mbi marrëveshjen mbi fajësinë, dhe me këtë rast, P, në emër të familjës, shprehu keqardhejn e tij lidhur me dënimin e propozuar.

Marrëveshja mbi Fajësinë u pranua nga Gjykata ditën e seancës, sipas Nenit 308A, Paragrafët (10) dhe (15) të KPPK.

Pas marrjes në pyetje të të Akuzuarit, nga avokati i tij mbrojtës dhe Prokurorja Publike, Gjykata vendosi që Marrëveshja mbi Fajësinë i plotësonte kushtet e Nenit 308A, Paragrafi (12); i akuzuari e kuptoi natyrën dhe pasojat e deklaramit të fajësisë, ai e bëri deklaratën mbi fajësinë vullnetarisht, pas këshillimit të mjaftueshëm me avokatin e tij mbrojtës, ai nuk u shtrëngua në asnjë formë dhe nuk e detyrua të deklaronte fajësinë. Për më tepër, deklarimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat e çështjes, dëshmitë e dëshmitarëve, dëshmitë e të akuzuarit dhe provat faktike në dosjen e lëndës. Prandaj, sipas Nenit 308A, Paragrafi (15) të KPPK, Gjykata urdhëroi që Marrëveshja mbi Fajësinë të dorëzohet në Gjykatë dhe të caktohej një seancë lidhur me caktimin e dënimit për në orën 14:30 të së njëjtës ditë.

Marrëveshja mbi Fajësinë u dorëzua në Gjykatë në të njëjtën ditë, më 22 nëntor 2010, në orën 13:30.

D. DËNIMI

Më 22 nëntor 2010 trupi gjykues dëgjoi argumentet e të gjitha palëve lidhur me dënimin.

Pas këshillimit, trupi gjykues vendosi caktimin e dënimit, sipas Nenit 308A, Paragrafi (15) të KPPK.

Me rastin e përcaktimit të dënimit Gjykata duhet të marrë parasysh si qëllimin e përgjithshëm të dënimit – që është të frenojë veprimtaritë shoqërisht të rrezikshme me anë të parandalimit të të tjerëve nga kryerja e veprave të ngjashme penale, ashtu edhe qëllimin specifik – të parandalojë kryesin e veprës penale nga ripërsëritja e veprës. Në përcaktimin e kohëzgjatjes së dënimit, Gjykata duhet të vlerësojë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, sipas Nenit 64, Paragrafi (1) të KPK.

Në rastin e Mensur Isufit, Gjykata konsideroi si faktorë rëndues faktin që viktima ishte mbajtësi i familjes së pesë fëmijëve dhe se i Akuzuari e kreu veprën penale ndërsa ishte duke kryer një veprimtari të paligjshme.

Gjykata konsideroi si faktor lehtësues që i Akuzuari nuk kishte precedentë të mëparshëm penalë, që ai pranoi fajësinë dhe shprehu pendesë për atë që kishte bërë. Megjithatë, meqë pendesa u shpreh pas shumë vjetësh dhe jo në një mënyrë bindëse, Gjykata nuk duhet t'i japë shumë peshë këtij fakti me rastin e caktimit të dënimit.

Për veprën penale të Vrasjes së Rëndë, sipas Nenit 147 të KPK, ligji parashikon dënimin e së paku 10 vitesh burgim. Duke marrë në konsideratë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, trupi gjykues vendosi dënimin me 12 vjet burgim për këtë veprë penale.

Për veprën penale të Pronësisë, Kontrollit, Posedimit apo Përdorimit të Paautorizuar të Armëve, sipas Nenit 328, Paragrafi (2) të KPK, ligji parashe një dënim me gjobë ose burgim nga 1 deri në 8 vjet. Trupi gjykues përcaktoi dënimin me 2 vjet burgim.

I Akuzuari kreu dy vepra penale. Sipas rregullave të përlllogaritjes së dënimit unik, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili dënim veç e veç, por jo aq i lartë sa shuma e dënimeve të dhëna. Trupi gjykues përcaktoi dënimin unik prej 13 vitesh burgim, në bazë të Nenit 71, Paragrafët (1) dhe (2), Pika 2) të KPK.

I akuzuari Mensur Isufi ka qenë në paraburgim që më 25 mars 2009. Kjo periudhë kohore do të përlllogaritet në dënimin e përcaktuar me burgim, sipas Nenit 73, Paragrafi (1) të KPK.

E. LIGJI I APLIKUESHËM


Veprat penale janë kryer më 11 shtator 2004. Në atë kohë, Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës (KPPK), i cili kishte hyrë në fuqi më 6 prill 2004, ishte ligji i aplikueshëm. Sipas Nenit 2, Paragrafët (1) dhe (2) të KPPK, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale, do të aplikohet ndaj të pandehurit, përveç se kur ligji i ri, është më i favorshëm për të akuzuarin.

Megjithatë, disa ndryshime, duke përfshirë institucionin e “Marrëveshjes mbi Fajësinë”, janë paraqitur në Kodin e Proçedurës Penale të Kosovës, me anë të Ligjit Nr. 03/L-003, që ka hyrë në fuqi më 6 janar 2009, si edhe në Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës, që është ndryshuar me anë të Ligjit Nr. 03/L-002, që ka hyrë në fuqi më 6 janar 2009. Siç duket, dispozitat lidhur me marrëveshjen mbi fajësinë, mund të aplikohen vetëm duke iu referuar ligjeve “të reja”, Kodit Penal të Kosovës (KPK) dhe Kodit të Proçedurës Penale të Kosovës (KPPK). Prandaj, Kodi Penal i Kosovës, është më i favorshëm për të akuzuarin dhe Gjykata i është referuar këtij ligji në Aktgjykimin lidhur me dënimin.

F. SHPENZIMET

I akuzuari është shpallur fajtor, prandaj ai duhet të paguajë shpenzimet e proçedurës penale, në bazë të Nenit 102, Paragrafi (1) të KPPK, përveç shpenzimeve të përkthimit me gojë e me shkrim, përgjatë gjithë proçedurës penale. Një vendim i veçantë lidhur me shpenzimet, do të dorëzohet nga Gjykata pasi të merren të dhëna të tilla, në bazë të Nenit 100, Paragrafi (2) të KPPK.

**Proçesmbajtëse
Tara Khan**



**Kryetare e Trupit Gjykses
Hajnalka Veronika Karpati**

Anëtarët e Trupit Gjykses: Christine Lindemann-Proetel

Nikolay Entchev

Këshillë Juridike:

Ky Aktgjykim sa i përket dënimin është bërë i plotfuqishëm në ditën e shpalljes së tij, pasi që nuk bie nën Nenin 308A, Paragrafi (8.1) i KPPK-së.